



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-17163/22 datë:01.07.2022



Npi – 01/209 datë: 07.07.2022

Bazuar në nenin 40.2 pika (d) si dhe neni 58 pika (j) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 45.4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, si dhe mbi bazën e prezentimit të Raportit gjashtë mujor financiar për vitin 2022 nga Zyra për Financa, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 07.07.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINANCIAR PËR GJASHTË MUJORIN E PARË
JANAR-QERSHOR 2022**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VII- të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më: 07.07.2022, me shumicën e votave miratoi, Raportin gjashtëmujor Financiar të Komunës së Shtimes Janar-Qershor 2022.

II

Kuvendi i Komunës ka marrë për bazë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi